

VENDIM
Nr.98, datë 16.2.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
BRENDSHME, PËR PËRBALLIMIN E SITUATËS EMERGJENTE TË KRIJUAR NË DISA
QARQE TË VENDIT, SI PASOJË E RESHJEVE TË DËBORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 13 të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012” dhe të ligjit nr.9900, datë 10.4.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Brendshme në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t’i shtohen fondet, në programin buxhetor “Rezerva e shtetit”, 20 000 000 (njëzet milionë) lekë, për mbulimin e disa shpenzimeve të nevojshme për blerje mallrash ushqimore për plotësimin e nevojave të banorëve në zonat e bllokuara, dhe në programin buxhetor “Emergjencia civile”, 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.
 2. Këto fonde të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha